

VENDIM
Nr. 701, datë 21.8.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2013 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi prej 29 100 000 (njëzet e nëntë milionë e njëqind mijë) lekësh, si subvecion (603), për garantimin e vazhdimësisë normale të funksionimit të këtij institucioni.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2013.
3. Ngarkohen Ministra e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha